



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 53 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësi, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03.06.2008, nenit 36 par.3 i Rregullës Financiare nr.01/2013 /MF-Shpenzimi i parave publike si dhe nenit 20 par 1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 28.03.2014 miratojë këtë:

**RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR NDARJEN E
SUBVENCIONEVE NGA BUXHETI I KOMUNËS**

I. DISPOZITAT THEMELORE

**Neni 1
Objekti i Rregullimit**

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedura e ndarjeve të mjeteve financiare të parapara për subvencione dhe transfere nga Buxheti i Komunës për programet si në vijim:

Nr.	Emërtimi i Programit
1.	Zyra e Kryetarit të Komunës
2.	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural
3.	Shëndetësia dhe përkujdesja
4.	Kultura, Rinia dhe Sporti
5.	Zyra lokale për komunitete

**Neni 2
Qëllimi**

Me këtë Rregullore synohet të ju ndihmohet me mjete financiare pa kthim, personave juridik , dhe personave fizik për arritjen e qëllimeve në avancimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, edukativo arsimore, të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, të përkrahjes dhe integritetit të komuniteteve, të përparimit të bujqësisë si dhe të zhvillimit të kulturës dhe sportit .

II. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

**Neni 3
Subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës**

Kryetari i Komunës nga kategoria ekonomike përkatësisht pozicioni buxhetor Subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin përkatës , sipas kërkesave të arsyetuara të

palëve , ndan mjete financiare- buxhetore, për personat juridik dhe fizik sipas procedurës vijuese të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 4

Subvencionet për personat juridik

Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara ndan ndihmë momentale për personat juridik përkatësisht Organizatat joqeveritare aktive të cilat kërkojnë mbështetje financiare për realizimin e projekteve të ndryshme, institucionet fetare, organizatat që merren me aktivitete të ndryshme shkencore, Këshillat e fshatrave, lagjeve, grupet e qytetarëve dhe të ngjashme të cilët ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Lipjanit.

Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për personat juridik deri në 2000 € ndërsa mbi lartësinë e kësaj shume nevojitet marja e pëlqimit nga Kuvendi Komunal.

Pas aprovimit të kërkesës nxirret Vendimi në të cilin duhet të specifikohet shuma e lejuar për realizimin e projektit të propozuar si dhe obligimi për personin juridik që pas realizimit të projektit të sjell raport me shkrim mbi mjetet e shpenzuara duke i bashkëngjitur edhe faturat në pajtim me planin financiar i cili duhet ti bashkëngjitet projektit të prezentuar.

Neni 5

Dokumentacioni i kërkuar për personat juridik

Personat juridik të cilët parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:

1. Çertifikatën e regjistrimit të personit juridik,
- 2..Çertifikatën e numrit fiskal,
3. Numrin e xhirollogarisë bankare të personit juridik,
4. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve,
5. Autorizimi,
6. Projekti
7. Plani financiar
8. Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkojnë edhe dëshmi tjera plotësuese.

Neni 6

Subvencionet për personat fizik

Kryetari i Komunës, sipas kërkesave të arsyetuara, ndan ndihmë momentale për personat fizikë përkatësisht për raste urgjente të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore, varfëri të skajshme për familje apo individ të caktuar me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm, për studentë të dalluar në studime të rregullta me notë mesatare mbi 8 dhe përjashtimisht ndan ndihmë për studentë të rregullt të cilëve për shkak të kushteve të vështira ekonomike mund të ju rrezikohet seriozisht përfundimi i studimeve.

Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për personat fizik deri në 1500 €

Pas aprovimit të kërkesës nxirret Vendimi me shkrim mbi shumën e lejuar.

Neni 7

Dokumentacioni i kërkuar për personat fizik

Personat fizik të cilët parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:

- 1.Fotokopjen e letërnjoftimit,
2. Fotokopjen e xhirollogarisë bankare

3. Dokumentacioni mjekësor i specialistit si dhe dëshmi të shpenzimeve mjekësore (për rastet e sëmundjes së rëndë)
4. Dëshmia për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e mundshme elementare
5. Fotokopja e Indeksit dhe vërtetimi mbi studimet (për studentë)
6. Gjendja e rëndë ekonomike – familjare e vërtetuar.

III. BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Neni 8

Subvencionimi në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural

Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural nga kategoria ekonomike : Subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari ndan mjete financiare për aktivitetet në vijim:

1. Subvencionimi i projekteve nga lëmi i pemëtarisë, lavëtarisë, blegtorisë, shpeztarisë, perimtarisë etj, pastaj përmes panaireve dhe përkrahjes me farëra dhe plehëra;
2. Subvencioni i Shoqatave të cilat kanë për qëllim zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në Komunën e Lipjanit.
3. Me rastin e shqyrtimit të kërkesave, përparësi do të kenë projektet të cilat realizohen me bashkëfinancim.

Neni 9

Kushtet , Kriteret dhe dokumentacioni që duhet bashkëngjitur për subvencionim në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural

Aplikuesit për subvencionim në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural duhet të plotësojnë aplikacionin të cilit i bashkëngjesin dokumentacionin si vijon:

1. Projektin,
2. Planin financiar,
3. Kopjen e letërnjoftimit,
4. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit
5. Kopjen çertifikates së regjistrimit (personat juridik)
6. Fotokopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar për tërheqjen e mjeteve dhe autorizimi (personat juridik)
7. Dëshminë nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punëshme në pronësi (fletën poseduese)
8. Kontrata për sipërfaqen e marrë me qera, duke bashkëngjitur fletën poseduese të qiradhënsit,
9. Dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë

Drejtorati për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural lejon ndarjen e mjeteve për persona fizik dhe juridik deri në 1500 €, ndërsa mbi lartësinë e kësaj shume nevojitet marja e pëlqimit nga Kuvendi Komunal.

Pas aprovimit të kërkesës nxirret Vendimi në të cilin duhet të specifikohet shuma e lejuar për realizimin e projektit të propozuar si dhe obligimi për përfituesin e subvencionit që pas realizimit të projektit të sjell raport me shkrim mbi mjetet e shpenzuara duke i bashkëngjitur edhe faturat në pajtim me planin financiar i cili duhet ti bashkëngjitet projektit të prezentuar.

IV. SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE

Neni 10

Subvencionimi në fushën e shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale

Drejtorati për shëndetësi dhe përkujdesje sociale është kompetent për shqyrtimin e kërkesave eventuale për ndihmë momentale individit apo familjes .

Ndihma momentale i ndahet individit apo familjes që përballet me gjendje të vështirë ekonomike, pa kurrfarë burimi të ardhurave personale, individëve që vuajnë nga sëmundje të ndryshme të cilët përballen edhe me vështirësi financiare që ua pamundëson trajtimin e sëmundjes apo blerjen e barërave si dhe personave me aftësi të kufizuara dhe me të meta mentale .

Kërkesat e pakompletuara dhe kërkesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret për ndihmë momentale sipas kësaj Rregulloreje do të refuzohen nga Drejtorati ndërsa për kërkesat të cilat i plotësojnë kriteret do të lëshohet Vendim mbi shumën e lejuar dhe qëllimin e lejimit të mjeteve.

Drejtorati për shëndetësi dhe përkujdesje sociale lejon ndarjen e mjeteve për rastet e mbrojtjes shëndetësore dhe përkujdesje sociale në lartësi deri në 500 €

Neni 11

Kushtet, Kriteret dhe dokumentacioni që duhet bashkëngjitur për subvencionim në lëmin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

Individët të cilët parashtrojnë kërkesë për subvencionim nga Drejtorati i Shëndetësisë duhet ti plotësojnë këto kushte dhe kriteret si dhe të bashkëngjiesim dokumentacionin si në vijim:

- 1) Dokumentacioni mjekësor i specialistit si dhe dëshmi të shpenzimeve mjekësore
- 2) Kartela e asistencës sociale (njera ndër kriteret)
- 3) Fotokopja e letërnjoftimit
- 4) Fotokopja e llogarisë bankare
- 5) Fotokopja e çertifikatës së lindjes (për fëmijën)

V. KULTURA, RINIA DHE SPORTI

Neni 12

Subvencionimi në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport ndan ndihmë momentale nga kategoria ekonomike subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, për personat fizik dhe juridik përkatësisht Organizatat e ndryshme joqeveritare aktive, Klubet sportive, rinore etj që jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Lipjanit nga lëmi i kulturës rinisë dhe sportit me qëllim të mbështetjes financiare të projekteve të ndryshme si vijon:

a.) Projektet nga fusha e kulturës si psh. veprimtaritë botuese, veprimtaritë teatrale, veprimtaritë filmike, artet pamore, trashëgimia kulturore, përkrahje për grupet artistike, projektet për çështjet gjinore dhe integritet socio-kulturore

b.) Projektet në fushën e rinisë dhe sportit si psh. masivizimi i sportit për të rinj, përkrahje për sportistët dhe klubet e suksesshme, avancimin e organizimit në klubet sportive të femrave, bashkëpunimi me organizatat e ndryshme sportive vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme sportive, integrimin e minoriteteve në aktivitete dhe në gara të rregullta kosovare, përkrahje e organizimit të klubeve për persona me aftësi të kufizuara.

Pas aprovimit të kërkesës nxirret Vendimi në të cilin duhet të specifikohet shuma e lejuar për realizimin e projektit të propozuar si dhe obligimi për personin fizik apo juridik që pas realizimit të projektit të sjell raport me shkrim mbi mjetet e shpenzuara duke i bashkëngjitur edhe faturat në pajtim me planin financiar i cili duhet të bashkëngjitet projektit të prezentuar.

Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport lejon ndarjen e mjeteve deri në 1500 € ndërsa për shumën mbi lartësinë e kësaj shume kërkohet pëlqimi i Kuvendit Komunal.

Neni 13

Kushtet, Kriteret dhe dokumentacioni që duhet bashkëngjitur për subvencionim në lëmin e kulturës, rinisë dhe sportit

Personat fizik apo juridik të cilët parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport duhet ti plotësojnë këto kushte, kriteret si dhe të bashkëngjiesim dokumentacionin si në vijim:

1. Projektin i cili duhet përfshijë të gjitha aktivitetet e planifikuara numrin e pjesëmarrësve, qëllimin të priturat etj.
2. Agjendën e trajnimeve (në rastet kur planifikohet organizimi i trajnimeve nga lëmia e kulturës, rinisë, sportit, çështjeve gjinore dhe integriteteve socio-kulturore etj.),
- 3) Datën dhe vendin e mbajtjes në rastet e organizimit të lojërave sportive, shfaqjeve teatrale, shfaqjes së ndonjë filmi, promovimit të librit dhe të ngjashme,
- 4.) Certifikatën e regjistrimit të personit juridik,
- 5.) Certifikatën e numrit fiskal,
- 6.) Planin financiar,
- 7.) Fotokopjen e letërnjoftimit ,
- 8.) Fotokopjen e xhirologarisë bankare të personit fizik apo juridik (varësisht prej kërkesës).
- 9.) Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohej edhe dëshmi tjera plotësuese.

VI.ZYRA LOKALE PËR KOMUNITETE

Neni 14

Subvencionimi nga ana e Zyrës Lokale Për Komunitete

Zyra Lokale për Komunitete nga kategoria ekonomike subvencionet e planifikuara për Zyrën lokale për komunitete sipas kërkesave të arsyetuara ndan ndihmë momentale për personat fizik- pjesëtarët e komuniteteve që jetojnë në territorin e Komunës së Lipjanit në rastet e varfërisë së skajshme.

Zyra Lokale për Komunitete nga e njëjta kategori ndan ndihmë momentale me qëllim të përkrahjes së trajnimeve të ndryshme të organizuara nga komunitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të tyre, edukimim, integrimin dhe të ngjashme.

Zyra Lokale për komunitete lejon ndarjen e mjeteve deri në shumën deri në **500 €**

Kërkesat e pakompletuara dhe kërkesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret për ndihmë momentale sipas kësaj Rregulloreje do të refuzohen nga Zyra Lokale e Komuniteteve ndërsa për kërkesat të cilat i plotësojnë kriteret do të lëshohet Vendim mbi shumën e lejuar dhe qëllimin e lejimit të mjeteve.

Neni 15

Kushtet, Kriteret dhe dokumentacioni që duhet bashkëngjitur për subvencionim nga ana e zyrës lokale për komunitete

Personat të cilët parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare në Zyrën Lokale për Komunitete duhet ti plotësojnë këto kushte, kriteret si dhe të bashkëngjiesim dokumentacionin si në vijim:

- 1.) Gjendja e rëndë ekonomike (familje e vërtetuar)
- 2.) Agjenda e trajnimeve (me rastin e organizimit të trajnimeve të cekura në nenin paraprak)
- 3) Fotokopja e letërnjoftimit
- 4.) Fotokopja e xhirologarisë bankare

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16 Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit Komunal.

Nr. 15-400-13203
Lipjan, më 03-04-2014

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani Hajnuni

